



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Raport Konsultativ

Shqyrtimi i Aplikimit të ALPEX për Tarifat e NEMO 2026-2028

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur me qëllim të konsultimit të palëve të interesit. Raporti nuk paraqet Vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të konsiderohet si i tillë.

18 dhjetor 2025



Përmbajtja

Hyrje	2
Si mund të komentohen propozimet e ZRrE?	3
1 Korniza ligjore dhe metodologjike	4
2 Përshkrimi i operatorit dhe funksionimit të tregut	4
3 Funksionimi i tregut dhe vlerësimi i të dhënave të transaksioneve	5
4 Përmbajtja e aplikimit të ALPEX-it dhe qasja e ZRRE-së në vlerësim	6
5 Llogaritja e të Hyrave të NEMO-s sipas metodologjisë.....	6
6 Të Hyrat e propozuara të NEMO për periudhën 2026-2028	7
7 Lista e tarifave të propozuara për ALPEX	10

Hyrje

Ky raport konsultativ është përgatitur nga Zyra e Rregullatorit për Energji në kuadër të ushtrimit të kompetencave të parashikuara me Ligjin Nr. 05/L-084 “Për Rregullatorin e Energjisë” dhe Ligjin Nr. 05/L-085 “Për Energjinë Elektrike”, me qëllim shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga Shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX SHA, Dega në Kosovë, për miratimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për periudhën tarifore 2026–2028. Ky shqyrtim kryhet në kuadër të zbatimit të Metodologjisë për Përcaktimin e Tarifave për Operatorin e Emëruar të Tregut të energjisë Elektrike (NEMO), e miratuar nga Bordi i ZRRE-së në vitin 2024, dhe përbën pjesë integrale të procesit të rishikimit rregullativ që i paraprin vendimit të Bordit për miratimin e strukturës tarifore për periudhën e ardhshme tarifore. Periudha Rregulluese për të cilën Tarifat NEMO pas aprovimit mund të jenë në fuqi është një periudhë 3 vjeçare ku kufijtë e miratuar të të hyrave të rregulluara mbeten në fuqi deri në momentin e Rishikimit të Tarifave të NEMO-s mbështetur në dispozitat e Shtojcës III të Metodologjisë.

Përgatitja e këtij raporti synon të sigurojë një analizë të plotë dhe të paanshme të të gjitha elementeve të paraqitura nga operatori, duke përfshirë përshkrimin e aktivitetit të tij operacional, të dhënat e tregut dhe të transaksioneve, treguesit financiarë të realizuar, parashikimet për periudhën 2026–2028, si dhe strukturën e kostove të raportuara që lidhen me ushtrimin e aktivitetit të NEMO-s në territorin e Kosovës. Raporti synon gjithashtu të



garantojë transparencën dhe integritetin e procesit rregullativ, duke vënë në dispozicion të palëve të interesuara një dokument të detajuar që pasqyron mënyrën e interpretimit të të gjitha komponentëve të kërkesës nga ana e ZRRE-së.

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) për të:

- paraqitur analizën teknike të kërkesës së paraqitur nga shoqëria ALPEX sh.a.,
- sqaruar komponentët kryesorë të tarifave të NEMO-s sipas metodologjisë,
- prezantuar të dhënat, llogaritjet dhe justifikimet e paraqitura nga operatori,
- ftuar palët e interesuara të japin komente dhe opinione me shkrim.

Brenda këtij raporti paraqiten të gjitha elementet ligjore, rregullative dhe metodologjike që përbëjnë bazën teknike të shqyrtimit. Ai përfshin shqyrtimin e strukturës së kostove të operatorit sipas komponentëve të metodologjisë, përfshirë bazën e rregulluar të aseteve nga i cili rrjedh amortizimin, kostot e operimit dhe mirëmbajtjes, kostot e qiras së platformës, normën e lejuar të kthimit të kapitalit të vet. Për më tepër Aplikacioni i ALPEX, ofron një vlerësim të plotë të hyrave dhe shpenzimeve si realizime historike të operatorit për periudhën 2020–2025, me qëllim sigurimin e besueshmërisë së parashikimeve për periudhën tarifore 2026–2028.

Raporti përbën gjithashtu materialin themelor që do të publikohet në kuadër të konsultimit publik, me synim informimin e palëve të interesuara dhe marrjen e komenteve dhe vërejtjeve të tyre përpara finalizimit të vendimit përfundimtar tarifar.

Në vijim të hyrjes, dokumenti është strukturuar në mënyrë të atillë që të pasqyrojë qartë metodologjinë e përdorur në vlerësim, rezultatet e analizës dhe përfundimet që dalin nga shqyrtimi i të gjitha elementeve të kërkesës së ALPEX SHA – Dega në Kosovë.

Si mund të komentohen propozimet e ZRRE?

Palët të cilat dëshirojnë të paraqesin komentet e tyre rreth propozimeve të ZRRE-së, ftohen që të dorëzojnë komentet e tyre me shkrim në postën elektronike ero.pricing-tariffs@ero-ks.org jo më vonë se 4 janar 2026. Gjithashtu, komentet mund të dërgohen me postë në adresën:

Zyra e Rregullatorit për Energji
Departamenti për Tarifa dhe Çmime



1 Korniza ligjore dhe metodologjike

Korniza ligjore që mbështet shqyrtimin e kërkesës së ALPEX-it buron nga kuadri i legjislacionit primar dhe akteve nënligjore të sektorit energjetik. Ligji bazë i sektorit, Ligji Nr. 05/L-085 “Për Energjinë Elektrike”, parashikon parimet dhe strukturën e organizimit të tregut me shumicë të energjisë elektrike, si dhe vendos detyrimet e operatorëve të licencuar që kryejnë funksione në tregjet e organizuara. Ligji ngarkon ZRRE-në me kompetencën për të rregulluar dhe miratuar tarifat e operatorëve në mënyrë që të sigurohet funksionimi i qëndrueshëm i tregut, mbrojtja e palëve të interesuara dhe shmangia e sjelljeve të padrejta apo diskriminuese.

Ligji Nr. 05/L-084 “Për Rregullatorin e Energjisë” përcakton kompetencat e bordit të ZRRE-së në proceset e shqyrtimit tarifar. Ky ligj njeh autoritetin e plotë të ZRRE-së për të miratuar metodologji tarifore dhe për të rishikuar të gjitha kërkesat për të hyra dhe tarifa bazuar në dokumentacionin e paraqitur.

Metodologjia e Përcaktimit të Tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar nga Bordi i ZRRE-së në vitin 2024, paraqet bazën teknike dhe llogaritëse që përdoret për të përcaktuar të ardhurat e lejuara të NEMO-s. Ajo përkufizon formulën e plotë të të ardhurave të lejuara, mënyrën e llogaritjes së bazës së rregulluar të aseteve, normën e kostos mesatare të ponderuar të kapitalit (WACC), amortizimin, kostot operative, kapitalin e punës dhe trajtimin e të ardhurave jo-tarifore. Kjo metodologji është hartuar në përputhje me praktikat evropiane dhe me mënyrën se si zbatohen parimet rregullative tek operatorët e tregjeve të organizuara në shtetet anëtare të BE-së.

Shqyrtimi i kërkesës së ALPEX-it kryhet duke u mbështetur drejtpërdrejt në këtë metodologji dhe çdo element i paraqitur nga operatori vlerësohet në raport me kërkesat dhe kufizimet që metodologjia vendos. Për më tepër, në analizë merren parasysh edhe vendimet e mëparshme të ZRRE-së që lidhen me licencimin dhe emërimin e ALPEX-it si NEMO për zonën e ofertimit të Kosovës.

2 Përshkrimi i operatorit dhe funksionimit të tregut

Operatori ALPEX ushtron një funksion thelbësor në tregun energjetik të Kosovës dhe Shqipërisë. Ai administron platformën e tregtimit për tregun e Ditës në Avancë dhe tregun Brenda Ditës, si dhe platformën e klerimit dhe shlyerjes financiare. Përmes implementimit të tregjeve të organizuara dhe bashkimit të tyre, operatori ka mundur një hap cilësor drejt integritetit rajonal dhe më tej drejt integritetit në tregjet e koordinuara të BE-së SDAC dhe SIDC.



Tregu i Ditës në Avancë në Shqipëri është vënë në funksion në prill 2023, ndërsa në Kosovë në janar 2024. Kjo ka bërë të mundur bashkimin e dy tregjeve që nga momenti i aktivizimit të platformës në Kosovë. Më tej, në dhjetor 2024 është aktivizuar tregu Intraday, duke plotësuar dy segmentet kryesore të tregtimit që një NEMO duhet të ofrojë. Funksionimi i marrëveshjeve operative të bashkimit të tregjeve ka mundësuar koordinim të plotë të hapjes dhe mbylljes së portave, si dhe përdorimin e procedurave normale, rezervë dhe alternativ të kërkuara nga arkitektura e SDAC dhe SIDC.

3 Funksionimi i tregut dhe vlerësimi i të dhënave të transaksioneve

Të dhënat për vitin 2024 dhe 9-mujorin 2025 tregojnë një treg energjetik funksional me volum të qëndrueshëm transaksionesh. Diferencat çmimore minimale midis Shqipërisë dhe Kosovës gjatë vitit 2024 tregojnë se bashkimi i tregjeve ka funksionuar pa pengesa të rëndësishme. Rritja sezonale e diferencave çmimore në periudhën korrik–gusht 2025 lidhet me ndryshimet strukturore në disponueshmërinë e energjisë dhe nivelet e konsumit që zakonisht shfaqen në këtë periudhë.

Nga pikëpamja rregullative, këto të dhëna konfirmojnë se operatori ka përmbushur detyrimet operacionale dhe teknike për ofrimin e një tregu të qëndrueshëm dhe të aksesueshëm për të gjithë pjesëmarrësit.

Në tabelën në vijim është një përmbledhje e transaksioneve të volumeve të energjisë dhe vlerave financiare të realizuara në tregjet e ALPEX për vitin 2024 dhe për 9-mujorin e vitit 2025.

Tabela 1 Klerimimi i transaksioneve në Tregjet e ALPEX për dy Zonat e Ofertimit

Klerimi i Transaksioneve në Tregjet e ALPEX për dy Zonat e Ofertimit				
Periudha	Volumi_Blerje_MWh	Vlera_Blerje_Euro	Volumi_Shitje_MWh	Vlera_Shitje_Euro
Total 2024	1,173,477	125,316,114	1,173,477	125,314,653
Total 9 muaj 2025	1,155,085	129,091,548	1,155,085	129,018,633

Gjatë periudhës janar–shtator 2025, tregjet e energjisë në të dy zonat e ofertimit kanë vijuar rritjen dhe stabilitetin operativ. Transaksionet e kryera në tregjet DAM dhe IDM për Shqipërinë dhe Kosovën demonstrojnë rritje të aktivitetit tregtar, duke reflektuar zgjerimin e pjesëmarrjes së aktorëve dhe forcimin e mekanizmave të negocimit dhe klerimit.



4 Përmbajtja e aplikimit të ALPEX-it dhe qasja e ZRRE-së në vlerësim

Aplikimi i ALPEX përfshin të dhënat financiare të pesë viteve të fundit, projeksionet e periudhës 2026–2028, strukturën e asetëve, kostot e operimit, koston e platformës, amortizimin, llogaritjen e WACC, kapitalin e punës dhe listën e tarifave të propozuara. ZRRE ka shqyrtuar përputhshmërinë e këtyre elementeve me metodologjinë dhe ka analizuar edhe trendet historike të kostove dhe të ardhurave.

Meqenëse ALPEX operon në dy zona ofertimi (Shqipëri dhe Kosovë), analiza ka marrë parasysh natyrën ndërkufitare të shpenzimeve, detyrimet teknike dhe financiare që burojnë nga pjesëmarrja në SDAC dhe SIDC, si dhe rreziqet që mund të paraqiten në rast të nënfinancimit.

Pra, ekziston një treg i përbashkët (Market Coupling) ndërmjet dy vendeve-Shqipëri&Kosovë, atëherë parimi rregullator standard është që kostot dhe të hyrat e operatorit të tregut (NEMO-së) të trajtohen në mënyrë të konsoliduar, me qëllim: të ketë tarifë uniforme, të shmangen shtrembërimet në treg dhe të garantohet trajtim i barabartë për pjesëmarrësit.

Të dhënat financiare për periudhën 2020–2024 tregojnë se operatori ka kaluar një fazë të nevojshme për vendosjen e platformës së tregtimit. Aktiviteti ka filluar të gjenerojë të ardhura vetëm pasi tregu i Ditës në Avancë u bë funksional në të dy zonat. Struktura aktuale e kostove operative për vitin 2026 përfshin shpenzime të konsiderueshme për platformën teknike, shpenzimet IT, qiratë e zyrave, shpenzimet e personelit dhe shpenzimet e tjera të domosdoshme për funksionimin e tregut të Ditës në Avancë dhe tregut Brenda Ditës.

Në përputhje me metodologjinë, ZRRE ka shqyrtuar secilin komponent të kostove të raportuara dhe ka vlerësuar se ato reflektojnë nevojat reale të operatorit për ofrimin e një shërbimi të pandërprerë dhe për plotësimin e detyrimeve të tij të licencës. Amortizimi është llogaritur sipas sistemit fiskal dhe është i justifikueshëm në raport me natyrën e asetëve të përdorura. Kapitali i punës llogaritet sipas formulës së metodologjisë dhe reflekton nevojën e operatorit për të mbajtur një nivel të mjaftueshëm likuiditeti për mbulimin e ciklit të shpenzimeve.

5 Llogaritja e të Hyrave të NEMO-s sipas metodologjisë

Në këtë dokument janë përcaktuar formulat për llogaritjen e të hyrave të lejuara të rregulluara të NEMO bazuar më Metodologjinë.



Të hyrat e rregulluara të lejuara NEMO (NEMORR) do të llogariten në Rishikimet Tarifore duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$NEMORR = (RAB * WACC) + (OPMC + DEPC + WCLC + LICC - NTFR)$$

Ku janë:

NEMORR Të hyrat e lejuara të NEMO

RAB Baza e rregulluar e asetëve

WACC Kosto mesatare e ponderuar e kapitalit

OPMC Kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes

DEPC Kostot e lejuara të amortizimit

WCLC Kapitali i Punës

LICC Tarifa dhe taksat e licencës

NTFR Të hyrat jo-tarifore

Norma e 'Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit - WACC' mbi bazën e rregulluar të asetëve neto do të përllogaritet sipas formulës në vijim:

$$WACC = [ES * AroE / (1-T)] + (DS * CoD) \quad ES + DS = 1$$

Ku janë: ES Objektivi për raportin e kapitalit të vet në RAB

T Norma e taksës së korporatës

ARoE Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse

DS Objektivi për raportin e borxhit në RAB

CoD Kosto e borxhit

6 Të Hyrat e propozuara të NEMO për periudhën 2026-2028

Metodologjia e llogaritjes së tarifave të NEMO-s për periudhën 2026–2028 tregon qartë se struktura e të hyrave të lejuara dominohet nga kostot e operimit dhe mirëmbajtjes (OPMC), të cilat përbëjnë mbi 90% të kostove të përgjithshme. Komponenti RAB·WACC ka ndikim minimal në tarifë, për shkak se RAB është shumë i ulët si rezultat i amortizimit të akumuluar (DEPC) dhe mungesës së investimeve të reja kapitale. Vlera e RAB-it bie nga 78,864 € në 2026 në vetëm 20,087 € në 2028, duke reflektuar një portofol minimal asetesh të rregulluara.



WACC mbetet konstant në 3.53%, duke përdorur vetëm kapital të vetin (ES=100%, DS=0%), me ARoE 3% pas tatimi dhe normë tatimore 15% e cila është e aplikueshme në Shqipëri. Kjo strukturë sjell kthim shumë të ulët rregullator (vetëm 2,783 € në 2026, 1,746 € në 2027 dhe 709 € në 2028).

Kostot OPEX janë elementi themelor i tarifës. Brenda OPMC, shpenzimi më i madh është qiraja e platformës së tregtimit dhe klerimit, me mbi 835 mijë € në vitet 2026–2027 dhe një rënie në 635 mijë € në 2028.

Amortizimi vjetor (DEPC) mbetet i ulët (28–30 mijë €), duke konfirmuar bazën minimale të aseteve. Kapitali i punës (WCLC), llogaritur si 1/12 e totalit OPEX + LICC, sillet rreth 167–181 mijë €, dhe ndjek trendin e kostove operative. Tarifat e licencës (LICC) janë të vogla, por rriten gradualisht nga 4,500 € në 2026 në 8,000 € në 2028.

Të ardhurat jo-tarifore (NTRF) mbeten zero, që nënkupton se të gjitha kostot e NEMO-s mbulohen vetëm përmes tarifës. Të hyrat totale rriten nga 1.56 milion € në 2026, në 1.68 milion € në 2027 dhe arrijnë 1.99 milion € në vitin 2028, reflektim i rritjes së kostove dhe nevojës për mbulim buxhetor.

Ndarja e të hyrave midis Shqipërisë dhe Kosovës mbetet e qëndrueshme, me rreth 56–60% që i atribuohet tregut shqiptar dhe 40–44% tregut kosovar, duke reflektuar ndarjen e volumit të tregtimit dhe koston e përbashkët të operimit të platformës.

Në përfundim, struktura e tarifës tregon një model tipik të NEMO-s me dominim të plotë të OPEX-it, RAB minimal, WACC të ulët, dhe një varësi të plotë nga tarifat për mbulim të kostove. Kjo kërkon fokus të vazhdueshëm në optimizimin e shpenzimeve operative dhe vlerësimin e kontratave të shërbimeve kyçe. Pra të hyrat e propozuara për zonën e Kosovës janë 0.669 milion euro për vitin 2026, 0.712 milion euro për vitin 2027 dhe 0.835 milion euro për vitin 2028.



Tabela 2 Metodologjia e llogaritjes së të hyrave të propozuara të NEMO për periudhën 2026-2028

Metodologjia e llogaritjes së të hyrave të lejuara të NEMO					
	Përshkrimi	Njësia	Parashikim Viti 2026	Parashikim Viti 2027	Parashikim Viti 2028
	$NEMORR = (RAB \cdot WACC) + (OPMC + DEPC + WCLC + LICC - NTFR)$	Euro	2,333,073	2,385,475	2,208,936
A.	$RAB \cdot WACC$		2783.44	1746.20	708.96
1	$RAB \cdot WACC$		2783.4	1746.2	709.0
	RAB - Baza e Rregulluar e Aseteve				
	WACC - Norma e Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit				
a.	$RAB = A - DEPC - AD - CG + WC + INV$	Euro	78864	49476	20087
	A - Vlera e njohur e aktiveve të dobishëm dhe në përdorim/operim në fillim të periudhës rregullatore		207,754	214,354	214,354
	DEPC - Kostot e lejuara të amortizimit (te akumuluar)		135,490	164,878	194,267
	AD - Asset disposal / Retirement of assets	Euro	-	-	-
	CG - asetet e financuara nga grantet	Euro	-	-	-
	WC - Shpenzimet kapitale	Euro	-	-	-
	INV - investime kur asetet është futur në shërbim dhe me koston e lejuar në planin e lejuar të	Euro	6,600	-	-
b.	$WACC = [ES \cdot ARoE / (1-T)] + [DS \cdot CoD] \quad ES + DS = 1$	%	3.53%	3.53%	3.53%
	ES - Objektivi për raportin e kapitalit të vet në RAB	Euro	100%	100%	100%
	T - Norma e takses së korporatës	Euro	15%	15%	15%
	ARoE - Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse	Euro	3%	3%	3%
	DS - Objektivi për raportin e borxhit në RAB	Euro	0%	0%	0%
	CoD - Kosto e borxhit	Euro	0%	0%	0%
B.	$OPMC$	Euro	2120388.3	2168405.7	2002871.0
	Kostot e lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes		2,153,590	2,203,029	2,041,321
1	Qera Ofruesit të Platformës të Tregtimit dhe Klerimit	Euro	845,000	835,710	635,700
2	Personeli, shpenzime të lidhura me Personelin	Euro	788,557	815,061	844,604
3	Shpenzime për materiale dhe lëndë djegëse	Euro	28,900	29,767	31,351
4	Shpenzime për furnitura dhe shërbime	Euro	243,147	283,515	281,091
5	Shpenzime postare dhe telekomunikimi	Euro	11,550	12,202	12,568
6	Qira zyra	Euro	88,000	88,000	88,000
7	Personel jashtë shoqërisë	Euro	48,992	47,592	47,592
8	Taksa, tatime dhe tarifa të tjera	Euro	41,543	42,284	45,411
9	Siguracion i Makinës	Euro	1,200	1,200	1,236
10	Publikime, reklama	Euro	26,000	16,075	21,197
11	Të tjera	Euro	2,000	2,060	2,122
12	Amortizimi	Euro	28,702	29,563	30,450
C.	$DEPC$	Euro	28702.00	29563.06	30449.95
	Kostot e lejuara të amortizimit të vitit	""	28702.00	29563.06	30449.95
D.	$WCLC$	Euro	176699.02	180700.47	166905.91
	Norma e Lejuar e Kapitalit të Punës	""			
	$WCLC = 1/12 \cdot (OPMC + LICC)$		176,699	180,700	166,906
	Koeficienti i kapitalit të punës: 1/12		0.0833333	0.0833333	0.0833333
	OPMC - kostot e lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes		2,115,888	2,163,346	1,994,871
	LICC - Tarifa dhe Taksat e Licencës		4,500	5,060	8,000
E.	$LICC$	Euro	4500	5060	8000
	Kostot dhe Taksat e Tarifave të Licencës	Euro	4,500	5,060	8,000
F.	$NTFR$	Euro	0	0	0
	Të ardhurat jo tarifore	Euro	-	-	-
	Të ardhurat Totale	Euro	1,558,591	1,683,712	1,992,389
	Të ardhurat nga Shqipëria	Euro	889,563	971,302	1,156,776
	Të ardhurat nga Kosova	Euro	669,028	712,410	835,613



7 Lista e tarifave të propozuara për ALPEX

Të dhënat e paraqitura tregojnë se ALPEX po përjeton një rritje të shpejtë të aktivitetit tregtar në të dy tregjet, Shqipëri dhe Kosovë, duke reflektuar integrimin e plotë në SDAC dhe rritjen e pjesëmarrjes së aktorëve të tregut. Strukturat tarifore mbeten plotësisht të pandryshuara nga 2025 deri në 2028, çka tregon se rritja e të hyrave nuk vjen nga rritja e tarifave, por nga zgjerimi i volumit të energjisë së tregtuar dhe shtimi i anëtarëve në bursë dhe klerim. Tregtimi DAM dhe IDM rritet ndjeshëm, çka rrit automatikisht të hyrat variabël nga komisionet për MWh të tregtuara. Të hyrat totale rriten nga rreth 1.2 milion € pritjet në 2025 në rreth 2 milion € në 2028, duke përfaqësuar një rritje prej rreth 67% aktiviteteve operative.

Megjithë rritjen e të hyrave, ALPEX rezulton me humbje financiare në të gjithë periudhën, për shkak se kostot fikse dhe ato të teknologjisë janë më të larta se të hyrat që mblidhen nga tarifat. Kjo situatë është e zakonshme për operatorët NEMO në fazat e para të zhvillimit të tregut, ku përparësi i jepet likuiditetit, pjesëmarrjes dhe stabilitetit të tregut mbi fitimin financiar. Në përgjithësi, performanca tregon një treg në zgjerim të vazhdueshëm, rritje të likuiditetit dhe të hyrave, por edhe nevojë për optimizim kostosh ose rishikim të modelit tarifar në të ardhmen për të arritur neutralitet financiar.

Tabela 3 Lista e tarifave të ALPEX

Lista e tarifave të ALPEX	Referenca në monedhën Euro	Pagesa e tarifës	Paguhet nga
Tarifa Administrative	200 €	Një herë	Anëtari i Bursës
Tarifa e Anëtarësimit për Anëtarin e Bursës	10,000€	Një herë	Anëtari i Bursës
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës në Tregun e Ditës në Avancë –	14,000€	Vjetore	Anëtari i Bursës
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës në Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	8,000 €	Vjetore	Anëtari i Bursës
Tarifa e Aderimit të Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit	7,000 €	Një here	Anëtari i Klerimit
Tarifa vjetore për Anëtarin Personal të Klerimit–	3,000 €	Vjetore	Anëtari i Klerimit



Tarifa Vjetore për Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit –	6,000 €	Vjetore	Anëtar i Klerimit
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh në Tregun e Ditës në Avancë	0.09 €	Ditore	Anëtar i Bursës
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh në Tregun e Ditës në Avancë	0.02 €	Ditore	Anëtar i Bursës
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh në Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	0.14 €	Ditore	Anëtar i Bursës
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh në Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	0.04 €	Ditore	Anëtar i Bursës
Tarifa e Tregtimit në Emër të Dikujt Tjetër	20 €	Urdhërporosi	Anëtar i Bursës
Tarifa për API Përdorues	2,000 €	Vjetore	Anëtar i Bursës
Mirëmbajtja e Llogarisë së Klerimit për Anëtarin Personal të Klerimit	100 €	Mujore	Anëtar i Klerimit
Tarifa Administrimit të Letër Garancisë Bankare	50 €	Kur depozitohet	Anëtar i Klerimit
Tarifa vjetore e Trajnimit	200 €	Vjetore	Agjenti Tregtar dhe Klerues
Tarifa e Provimit	100 €	Vjetore	Agjenti Tregtar dhe Klerues
Certifikata dixhitale për përdorues	50 €	Vjetore	Anëtar i Bursës / Anëtar i Klerimit
Tarifa Teknike	2,000 €	Vjetore	Anëtar i Bursës